



100 Vjet Pavarësi

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Ministri**

6390  
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 19.11.2012

**URDHËR**

Nr. 563, datë 19.11.2012

**“PËR**

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË NË  
“ARKITEKTURË DHE PLANIFIKIM URBAN” NË UNIVERSITETIN PRIVAT “POLIS”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 26/1.3.1, dhe të nenit 42/1, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 746, datë 24.10.2012 “Për miratimin e ndryshimit të statusit të institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Private”Universiteti Polis””,


**URDHËROJ:**

1. Hapjen, në përputhje me vendimin e Këshillit të Akreditimit nr. 373, datë 17.09.2012 (bashkëlidhur këtij urdhri), të programit të studimit të ciklit të tretë të doktoratës, në universitetin privat “Polis”, në: “Arkitekturë dhe Planifikim Urban”.
2. Programi i studimit i përcaktuar në pikën 1 të këtij Urdhri zgjat së paku 3 vite akademike dhe përfshin 60 kredite për studime të organizuara teorike, nga të cilat së paku 15 kredite teorike realizohen nga pedagogë të huaj me kualifikimin akademik të kërkuar për studimet e ciklit të tretë. Në përfundim të programit të studimit të doktoratës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr.).
3. Universiteti Privat “Polis”, do të realizojë këtë program studimi në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës (Universita degli Studi di Ferrara), Itali, sipas marrëveshjes dypalëshe të lidhur ndërmjet këtyre dy institucioneve të arsimit të lartë.

4. Procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programin e studimit të doktoratës, të jenë në përputhje me përcaktimet e udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 21 datë 30.07.2009 “Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e studimit të doktoratës, në institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar.
5. Studentët e programit të studimit të doktoratës pajisen me numër individual matrikulimi (NIM) sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënie të numrave të matrikullimit", i ndryshuar. Agjencia Kombëtare e Provimeve gjeneron NIM vetëm pas verifikimit të përmbushjes së detyrimeve të pikës 4 të këtij urdhri nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë.
6. Programi i studimit i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri të fillojë veprimtarinë në vitin akademik 2012-2013.
7. Universiteti privat “Polis” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtij programi studimi brenda vitit akademik 2013-2014.
8. Ngarkohet Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë për kontrollin periodik për zbatimin e standarteve akademike dhe të kërkimit shkencor sipas legjislacionit në fuqi.
9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
10. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Zëvendësministri për Arsimin e Lartë, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Privat “Polis”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

**MYQEREM TAJ**



**MINISTËR**

